

**QEVERIA E KOSOVËS
MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË**

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 2003/1

**PËR
FUSHËVEPRIMIN E ZYRES SË REGJISTRIMIT
DHE
REGJISTRIMIN E BIZNESEVE NË KOSOVË**

Prishtinë, 01 prill 2003

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSRTISË

Me qellim të implementimit të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2001/6 dhe Urdhëresës Administrative Nr. 2002/22, Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë nxjerr këtë:

UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 2003/1

PËR FUSHËVEPRIMIN E ZYRES SË REGJISTRIMIT DHE REGJISTRIMIN E BIZNESEVE NË KOSOVË

1. Hyrje

- 1.1 Zyra e regjistrimit të ndërmarrjeve afariste dhe emrave tregtar në Kosovë ('Zyra e Regjistrimit') është themeluar në bazë të Urdhëresës Administrative 2002/22 në pajtim me Rregulloren së UNMIK-ut 2001/6 mbi Ndërmarrjet Tregtare.
- 1.2 Zyra e regjistrimit zyrtarisht është hapur me 11 Nëntor 2002 në ndërtesën e Fakultetit të Ri Ekonomik, zyrja nr.8, si një Agjension i pavarur ekzekutiv, në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Kjo zyrë aplikacionet e para për regjistrim të përhershëm do ti pranojë duke filluar nga 13 Janari 2003, kur edhe do të pushojë së ekzistuari regjistrimi i përkohshëm.
- 1.2 Me këtë Udhëzim ipen udhëzime dhe detaje për procedurat e reja lidhur me regjistrimin e bizneseve të reja dhe reregjistrimin e:
- 1.3
 - Shoqërive aksionare,
 - Shoqërive me përgjegjësi të kufizuara,
 - Ortakërive të kufizuara
 - Ortakërive të përgjithshme, dhe
 - Nizneseve individuale
 - Ndermarrjeve të huaja

2. Fushëveprimi i Zyres së Regjistrimit

- 2.1 Zyra e regjistrimit do të jetë përgjegjëse për:
 - a) Regjistrimin e bizneseve të reja,
 - b) Reregjistrimi i bizneseve të regjistruara si të përkohshme,
 - c) regjistrimi i Emrit Tregtar i cili mund të shfrytëzohet nga cilido lloj i biznesit;
 - d) Regjistrimin e njësisve punuese të bizneseve kosovare;
 - e) regjistrimin e njësisve – përfaqësive të kompanive të huaja në Kosovë,
 - f) regjistrimi i ndryshimeve në informata të cilat kanë qenë të regjistruara me regjistrim të përkohshëm;

- g) pranimi i raporteve vjetore dhe pasqyrave vjetore financiare (bilanceve vjetore) nga Korporatat, Shoqëritë aksionare dhe Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar;
- h) fshierja nga regjistri i të gjitha bizneseve jo funksionale të cilat nuk janë në përputhje me legjislacionin përkatës ose bëjnë shkelje të nenit 34.4 të UA 2002/22;
- i) dizajnimi dhe distribuimi i formularëve përkatës për regjistrim,
- j) distribuimi i Çertifikatave për bizneset e regjistruara,
- k) dhënja e shenimeve dhe vertetimi i kopjeve të dokumentacionit nga Regjistri i biznesit,
- l) bashkëpunimi me Zyrën e statistikës, Administratën tatimore Zyrat dhe Agjensionet tjera,
- m) ruajtja e të dhënave të shkruara dhe elektronike,
- n) sigurimi i informatave publikut përmes publikimit të njoftimeve, të letrave me informata të parashtypura dhe kopjeve të dokumenteve si dhe operimi i faqes së internetit.

3. Formularët

- 3.1 Formularët të cilët janë pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi, duhet të shfrytëzohen për qëllime të aplikimit ose njoftimeve të cilat dërgohen në Zyrën e Regjistrimit:

Formulari A: Fletëparaqitja për regjistrim fillestar si dhe për ndryshime në shoqërinë aksionare, shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, ortakërinë e kufizuar ose kompaninë e huaj;

Formulari B: Fletëparaqitja për regjistrim të ri ose për ndryshime në biznesin individual ose ortakërinë e përgjithshme;

Formulari C: Fletëparaqitja për rezervimin e emrit tregtar;

Formulari D: Fletëparaqitja për shuarjen e biznesit

- 3.2. Formularit D i bashkangjitet dëshmia nga Autoriteti Tatimor që ka përmbushur të gjitha obligimet tatimore.

- 3.2 Formularët plotësuese mund të përpilohen më vonë.

4. Të dhënat të cilat shenohen në Regjistrin e Bizneseve

- 4.1 Në regjistrin e bizneseve regjistrohen të dhënat vijuese:

- Emertimi i biznesit;
- Numri i biznesit;
- Emri tregtar;
- Selia – adresa e biznesit respektivisht adresa e themeluesit ose pronarit;
- Forma e organizimit, respektivisht tipi i biznesit;
- Kapitali themelues;
- Veprimtaria e biznesit sipas NACE;
- Veprimtaria e import-exportit;
- Përgjegjësitë dhe autorizimet në qarkullim ndaj personave të tretë, llojin dhe formën e përgjegjesisë;
- Emrat e personave përgjegjës dhe kufinjët e autorizimeve të tyre;
- Njësitë punuese;
- Aktin e themelimit (Memorandumi ose Statuti) dhe datën e aprovimit;
- Raportet dhe pasqyrat financiare.

- Shuarja e biznesit.

4.2 Në Regjistër të biznesit shenohen të gjitha ndryshimet dhe plotësimet nga pika 4.1

5. Regjistrimet e reja të korporatave dhe ortakërive të kufizuara

- 5.1 Në Zyren e Regjistrimit mund të bëhet aplikimi për regjistrimin e Shoqërive aksionare, Shoqërive me përgjegjësi të kufizuara ose Ortakërive të kufizuara, duke i shfrytëzuar formularët përkatës. Këta formular së bashku me dokumentet tjera të nevojshme si dhe me dëftesën mbi pagesën taksës, dorëzohen në Zyrat regjionale të MTI ose në Zyrë të regjistrimit
- 5.2 Sipas nenit 26.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/6, kapitali themelor për Shoqëritë aksionare duhet të jetë së paku njëzetepesmiqë euro 25,000 €, ndërsa kapitali themelor për Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara duhet të jetë së paku dymijëepesqindeuro 2,500 € .
- 5.3 Aplikuesëve të cilët i plotësojnë kushtet e parapara ligjore, Zyra e Regjistrimit do të lëshojë certifikatën e regjistrimit, e cila do t'i dërgohet aplikuesit përmes zyrave regjionale të MTI.
- 5.4 Në bazë të nenit 28 të UA 2002/22, Shoqëria aksionare, Shoqëria me përgjegjësi të kufizuara ose Ortakëria e kufizuar do të konsiderohen si entitete legale në ditën e regjistrimit, e cila mirret si dita kur aplikacioni pranohet për regjistrim. Kjo ditë e regjistrimit mund të jetë disa ditë pas ditës së dorëzimit të aplikacionit e cila sipas nenit 9 të UA 2002/22 është dita në të cilën aplikacioni është pranuar. Para se të konfirmohet regjistrimi i entitetit legal nuk mund të fillohet me punë.

5.5 Formulimi i emrit

Përveç përjashtimeve të cilat janë cekur në nenin 20 të UA 2002/22, Emri i biznesit duhet të jetë unik dhe ai duhet ta ketë prapashitesën e cila i përgjigjet tipit të biznesit.

Shoqëria aksionare

- a) Nëse emri është në gjuhën Shqipe, duhet të përfundojë me **Shoqëri Aksionare** ose **SH.A.**
- b) Nëse emri është në gjuhën Angleze, duhet të përfundojë me **Joint Stock Company** ose **J.S.C.**
- c) Nëse emri është në gjuhën Serbe, duhet të përfundojë me **Deoničarsko Društvo** ose **D.D.**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuara

- a) Nëse emri është në gjuhën Shqipe, duhet të përfundojë me **Shoqëria me përgjegjësi të kufizuara** ose **SH.P.K.**
- b) Nëse emri është në gjuhën Angleze, duhet të përfundojë me **Limited Liability Company** ose **L.L.C.**
- c) Nëse emri është në gjuhën Serbe, duhet të përfundojë me **Društvo sa ograničenom odgovornošću** ose **D.O.O.**

Ortakëria e kufizuar

- a) Nëse emri është në gjuhën Shqipe, duhet të përfundojë me **Ortakëri e kufizuar** ose **O.K.**
- b) Nëse emri është në gjuhën Angleze, duhet të përfundojë me **Limited Partnership** ose **L.P.**

- c) Nëse emri është në gjuhën Serbe, duhet të përfundojë me ***Ograničeno partnerstvo*** ose ***O.P.***

5.6 Rezervimi i emrit

Sipas nenit 21 të UA 2002/22, emri i propozuar i korporatës ose Ortakërisë së kufizuar mund të rezervohet përmes formularit përkatës për një periudhë prej 180 ditësh.

Ndryshimet në shënimet e korporatave të cilat janë regjistruar

- 6.1 Për çfarëdo ndryshimi në Zyren e Regjistruar ose agjentin (përfaqësuesin) e regjistruar të korporatës duhet të njoftohet Zyra e Regjistrimit dhe kjo bëhet duke shfrytëzuar formularët përkatëse edhe atë në afat prej 5 dite pune, siç është e cekur në nenin 24 të UA 2002/22.
- 6.2 Çfarëdo ndryshimi në emrat ose adresat e drejtorëve ose personave të autorizuar të cilët janë të autorizuar ta përfaqësojnë korporatën duhet të lajmërohet në Zyre të Regjistrimit edhe atë brenda 14 dite pune prej ditës së ndryshimit.
- 6.3 Kur kemi të bëjmë me ndryshimet, të cilat lajmërohen në zyre të regjistrimit, të gjitha rubrikat relevante në formular duhet të plotësohen.

7. Raportet vjetore dhe pasqyrat financiare

- 7.1 Sipas nenit 33 të UA 2002/22, të gjitha Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe Shoqëritë aksionare në të ardhmën duhet ta dorëzojnë ose raportin vjetor ose pasqyrën financiare të përgatitur sipas nenit 4 ose 5 të Rregullores 2001/30 *mbi Themelimin e Bordit Kosovar mbi Standardet e Raportimit Financiar si dhe Regjimit Financiar të Ndërmarrjeve Afariste* si dhe duhet t'i përmbajë informatat të cilat kërkohen në nenin 33.1 të UA 2002/22.
- 7.2 Këto së pari do të aplikohen tek të gjitha Shoqëritë aksionare dhe Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara të regjistruara deri më **31 Dhjetor 2002**, të cilat duhet ta dorëzojnë raportin vjetor/pasqyrën financiare për vitin **2002** deri më **1 Korrik 2003**.

Mos respektimi i këtyre kërkesave do të rezultojë me shuarjen automatike të Shoqërive aksionare dhe Shoqërive me përgjegjësi të kufizuara sipas nenit 34 të UA 2002/22.

8. Marrëveshjet e përkohshme

Implikimet për Shoqëritë aksionare, Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe Ortakëritë e kufizuara

- 8.1 Me Konvertim me **12 Janar 2003**, i të dhënave prej RPB do të krijohet baza e re e të dhënave e cila përmban të gjitha të dhënatpër të gjitha bizneset e regjistruara përkohësisht me RPB Zyra e regjistrimit do bëjë verifikimin e informatave për të gjitha subjektet si vijon:
- a) Shoqëritë aksionare, Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe Ortakëritë e kufizuara të cilat kanë qenë të regjistruara me regjistrim të përkohshëm duhet t'i marrin deri me **30 prill 2003** të dhënat për biznesin e regjistruar – Totalin, në Zyrat regjionale të MTI, ose në Zyrën e regjistrimit në MTI në të cilën gjinden të gjitha informatat të cilat janë të regjistruara për atë subjekt.

- b) Të gjitha bizneset të cilat nuk e tërhiqin totalin deri me **30 prill 2003** mund të përfundojnë me shuarje të atij biznesi dhe me këtë rast mund të fillohet procedura e likuidimit, sipas nenit 41.5 të UA 2002/22.
 - c) Të gjitha parregullsitë në mes të informatave të regjistruara në RPB dhe gjendjes faktike të subjektit në fjalë duhet të lajmërohen në Zyre regjionale të MTI dhe pastaj këto ndryshime do t'i dërgohen prapë zyrave regjionale të MTI së bashku me dokumentet përkatëse para **31 Majit 2003**.
 - d) Duke u bazuar në të dhënat nga Regjistri Zyra e regjistrimit do të përgadis certifikatat e reja për regjistrim të të gjitha bizneseve.
- 8.2 Të gjitha certifikatat të cilat nuk tërhiqen deri me **31 maj 2003** mund të përfundojnë me shuarje të atij biznesi dhe me këtë rast mund të fillohet procedura e likuidimit, sipas nenit 41.5 të UA 2002/22.

Emrat tregtar dhe rezervimi i Emrit të biznesit

- 8.3 Fletëparaqitjet për regjistrimin e Emrit Tregtar ose për rezervimin e emrit të biznesit mund të dorëzohen në Zyre të Regjistrimit duke filluar nga **1 Maji 2003**. Të gjitha fletëparaqitjet të cilat grumbullohen deri atëherë do të konsiderohen si të kishin arritur në të njëjtën ditë.
- 8.4 Brenda muajit në vazhdim, Regjistruesi ose do ta regjistrojë ose do ta refuzojë ta regjistrojë cilëndo nga fletëparaqitjet, me përjashtim kur p.sh. për një emër janë pranuar dy ose më shumë fletëparaqitje.
- 8.5 Në raset të tilla, Regjistruesi mund të marrë në konsideratë faktin se a është shfrytëzuar ai emër edhe më heret nga ana e ndonjërit, ose ana e të gjithë aplikuesve dhe mund të vendos se cilën, nëse kjo është e mundshme, nga fletëparaqitjet ta pranojë për regjistrim.

Implikimet për bizneset individuale ose Ortakëritë e përgjithshme

- 8.6 Në mes **13 Janar 2003 dhe 30 Prill 2003** pronari i një biznesi individual ose një ortak në Ortakërinë e përgjithshme është i obliguar të ri-regjistrohet në Zyre të Regjistrimit duke e shfrytëzuar formularin përkatëse për këtë.

9. Kompanitë e huaja

- 9.1 Korporata ose një entitet i ngjashëm legal i regjistruar në një vend jashtë Kosovës mund ta regjistrojë një njësi ose një zyre përfaqësimi në Kosovë. Në raste të tilla, detajet e organizatës amë duhet të jipen në formularët përkatëse, duke dhënë adresën e zyrës së regjistruar ose adresë tjetër të ngjashme të korporatës në vendin e regjistrimit. Detajet e secilës njësi duhet të plotësohen në formularin përkatës. Organizata duhet të ketë agjentin e regjistruar në adresën e njësisë së saj në Kosovë, ku kjo adresë do të mirret si adresë valide për shërbime legale të cilat janë cekur në nenin 23 të UA 2002/22.

10. Emri i biznesit dhe emri tregtar

- 10.1 Emri i regjistruar i Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe Ortakërisë së kufizuar do të quhet Emër i biznesit. Emri i biznesit është emër zyrtar i biznesit.
 - a. Këto subjekte do të emërohen me Emër të biznesit në të gjitha procedurat gjyqësore dhe në të gjitha raportet me zyrtarët publik si dhe në të gjitha faturat të

- cilat i lëshojnë, porositë të cilat i bëjnë, pranimin e porosive, kontratat në cilat hyjnë dhe në dokumente tjera të ngjashme.
- b. Shoqëritë aksionare, Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe Ortakëritë e kufizuara mund të kenë të drejtë ekskluzive në Emër të biznesit. Emri i biznesit i Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara dhe Ortakërisë së kufizuar do të jetë i mbrojtur me ligj në Kosovë.
- 10.2 Emri i regjistruar i biznesit individual dhe Ortakërisë së përgjithshme do të përmbajë emrin e plotë të personit përgjegjës, për biznesin individual ose emrin e plotë të personit përgjegjës për Ortakërinë e përgjithshme. Emri i regjistruar i Ndërmarrjes së biznesit individual dhe Ortakërisë së përgjithshme do të quhet : **Emër i regjistruar**. Emri i regjistruar i biznesit individual dhe Ortakërisë së përgjithshme nuk do të jetë i vetëm dhe si i tillë nuk do të jetë i mbrojtur me ligj në Kosovë.
- 10.3 Shoqëritë aksionare, Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara, Ortakëritë e kufizuara, bizneset individuale dhe Ortakëritë e përgjithshme do të mund të regjistrojnë edhe Emrin tregtar. Këto subjekte do të kenë të drejtë ekskluzive në Emër tregtar, duke marr parasysh parakushtet e këtij akti.
- a) Emri tregtar mund të shfrytëzohet në marketing, në letra të ndryshme, në fatura dhe dokumente tjera të ngjashme, por nuk mund të zëvendësojë shfrytëzimin e detyrueshëm të Emrit të biznesit në letra, fatura etj. të paraqitura më lartë. Nenet 14.1 dhe 14.2 do të shfrytëzohen në mënyrë të ngjashme.

Kërkesat për Emër të biznesit për Shoqëritë aksionare, Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe Ortakëritë e kufizuara dhe Emrat tregtar për Shoqëritë aksionare, Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara, Ortakëritë e kufizuara, bizneset individuale dhe Ortakëritë e përgjithshme

Emri i biznesit dhe Emri tregtar vetëvetiu duhet të kuptohen si emra të një subjektit të caktuar të regjistruar. Emërimet e përgjithshme për tipin e

- 10.4 Aktivitetit i cili mendohet të ushtrohet, ose për shërbimet apo të mirat të cilat mendohet të ofrohen, ose emrat e komunave apo të vendeve apo rajoneve të ngjashme, nuk mund të shfrytëzohen si Emër i biznesit ose Emër tregtar. Në marrjen e këtij vendimi as një prapashtesë nuk do të bashkangjitet emrit të biznesit, e cila e bënë përcaktimin e llojit të biznesit. Emri i biznesit ose Emri tregtar i një subjekti nuk mund të përmbajë asgjë tjetër pos asaj që tregon për tipin e përgjegjësive së ndërmarrjes.
- a) Neni 20.2 i UA 2002/22 mund të shfrytëzohet në mënyrë të ngjashme.
- 10.5 Emri i biznesit ose Emri tregtar nuk mund të jenë të tillë që të kuptohen si mashtruese (hutuese).
- 10.6 Emri tregtar i biznesit individual dhe Ortakërisë së përgjithshme nuk mund të përmbajë mbiemër tjetër pos atë të pronarit ose pjesëmarrësit, nëse mbiemrat janë të shfrytëzuar në Emër tregtar.
- 10.7 Nëse një pjesëmarrës jep dorëheqje nga Ortakëria e përgjithshme, ose nëse emri i regjistruar ose Emri tregtar janë transferuar së bashku me vetë ndërmarrjen, emri i pjesëmarrësit të mëparshëm ose pronarit mund të mbetet si pjesë e Emrit të biznesit nëse ai pronar ose pjesëmarrësit kanë dhënë pëlqimin e tij/saj dhe nëse Emri i biznesit nuk është i tillë që të mund të kuptohet si mashtrues.
- 10.8 Emri i biznesit nuk duhet të jetë në kundërshtim me ligje ose të shkaktojë kundërvajtje.

10.9 Pos në rastet kur ekziston pëlqimi nga pronari për të bërë ate, Emri i biznesit ose Emri tregtar nuk duhet të :

- a) përfshijë asgjë që do të jap të kuptohet se është emër i dikujt tjetër, emër artistik ose i ngjashëm, pos nëse në shikim të parë është e qartë se është emër i dikujt që në një kohë të gjatë nuk është më në mesin e të gjallëve;
- b) përfshijë asgjë për çka do të mund bindeshim se është emër i shpeshtë i ndonjë fondacioni, asociacioni bamirës ose organizate tjetër të ngjashme;
- c) përfshijë asgjë për çka do të mund të bindeshim se janë tituj karakteristik për punën letrare ose artistike të dikujt me të drejta të mbrojtura autoriale, ose emër i veçantë i dalur si rezultat i krijimtarisë së tillë, emër ky që është mirë i njohur dhe i shpeshtë;
- d) jetë i tillë që të kuptohet gabimisht si Emër biznesi ose shenjë dalluese që është e ndarë për dikend tjetër, ose që është regjistruar përmes njoftimit të dorëzuar më parë;
- e) përfshijë emër i cili është karakteristikë për pronën e vërtetë të dikujt tjetër, ose çkado që do të kuptohej si e tillë.

Mbrojtja e Emrit të biznesit dhe Emrit tregtar

10.10 E drejta e Emrit të biznesit ose Emrit tregtar është e mbrojtur që nga dita e regjistrimit.

10.11 E drejta e shfrytëzimit të Emrit të biznesit shuhet me rastin e shuarjes së biznesit. E drejta e shfrytëzimit të Emrit të biznesit shuhet kur biznesi në fjalë çdoherë fshihet nga regjistri, pos nëse Emri i biznesit dhe vetë biznesi mirret nga dikush tjetër.

10.12 Sipas neni 37 i UA 2002/22 çertifikata e regjistrimit të Emrit të biznesit dhe Emrit tregtar është dëshmi se emri në fjalë është regjistruar dhe si i tillë është në shfrytëzim ekskluziv të aplikuesit.

- a) Në bazë të marrëveshjeve kalimtare të përmendura më lartë, prioritet do ti jipet subjektit i cili ka aplikuar më parë në Zyrën e Regjistrimit.
- b) Për ti ikur rrezikut që Emri i biznesit dhe Emri tregtar të keqkuptohen siç u përmend në nenet 9.1 deri 9.9 gjyqi mund të vendosë që, në të ardhmën, njëri ose edhe Emri i biznesit edhe Emri tregtar mund të shfrytëzohen vetëm në raste të veçanta, si p.sh. duke e cekur ose bashkangjitur edhe lokacionin ose cekur sqarime tjera plotësuese. Kjo vlen për të dyja subjektet.

Kohëzgjatja e regjistrimit të Emrit tregtar

10.13 Regjistrimi i parë i Emrit tregtar do të zgjasë 3 vite. Ai mund të ripërtrihet para skadimit të kësaj periudhe edhe për 5 vite tjera dhe pas kësaj periudhe edhe për 5 vite tjera. Nëse regjistrimi i Emrit tregtar nuk ripërtrihet para skadimit të këtij regjistrimi ai do të shuhet.

Shfrytëzimi i Emrave të biznesit dhe Emrave tregtar në kundërshtim me Aktet, dhe të drejtën për veprim etj.

10.14 ëse Emri i biznesit ose Emri tregtar shfrytëzohet ose është regjistruar në Zyre të Regjistrimit në kundërshtim me këtë akt, secili që ka interes ligjor ose edhe vet Ministria (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë) mund të ndërmarrin (iniciojnë)

procedurën ligjore ashtu që emri të shpallet jo i ligjshëm. Një procedurë e tillë gjyqësore poashtu mund të ndërmerret nëse në fillim të shfrytëzimit të tij emri ka qenë i ligjshëm por më vonë është bërë mashtrues ose i tillë që të mund të shkaktojë kundërvajtje.

- 10.15 Sipas procedurave ligjore, gjyqi mundet, sipas nenit 9.12 (b), ose sipas procedurave tjera ligjore të cilat janë ndërmarrë individualisht, të ndërmarrë hapa të tillë sa të pengojnë shfrytëzimin e mëtejshëm të Emrit të biznesit në formë e tillë të pa ndryshuar. Kjo pra është shkaku që shenjat, materiali lajmëruar etj. duhet të ndryshohen, shkatërrohen ose në marrëveshje me palën, ai i dorëzohet palës me ose pa kompenzim varësisht nga vendimi që e merr gjyqi.
- 10.16 Kushdo që me vetëdëshirë ose me neglizhim e ka shfrytëzuar Emrin e biznesit duke i shkelur të drejtat e dikujt tjetër është përgjegjës për kompenzimin e dëmeve. Ky kompenzim i dëmit mund të reduktohet ose të lirohet tërësisht nëse dëmet kanë qenë të vogla.
- 10.17 Nëse Emri i biznesit është shfrytëzuar me qëllim të mirë, gjyqi deri në një masë të arsyeshme mund të kërkojë kompenzim për dëmet, sidoqoftë, jo mbi fitimin që është paraparë të realizohet.

11 Implikimet për bizneset individuale dhe Ortakëritë e përgjithshme ekzistuese

11.1 Kërkesa për regjistrim

11.1.1 Deri më **31 Maj 2003**, biznesi nuk do të veprojë përveç nëse është:

a) i regjistruar sipas dispozitave të Rregullorës 2001/6 dhe Urdhëresës Administrative 2002/22 ose,

b) e ka certifikatën e regjistrimit të përkohshëm deri më 31 Maj 2003, të dalë nga rregullorja 2000/8 mbi Regjistrimin e Përkohshëm të biznesit në Kosovë

11.1.2 Prej **31 Maj 2003**, biznesi nuk mund të veprojë nëse nuk regjistrohet siç e kërkon Rregullorja 2001/6 dhe Urdhërsa Administrative 2002/22.

11.1.3 Neni 2.1 i Rregullores 2000/8 do të vazhdojë të jetë në fuqi nëse fjalat 'përkohshme' hiqet dhe nëse fjalët 'Zyra e regjistrimit të ndërmarrjeve afariste dhe emrave të tyre tregtar në Kosovë' t'i zëvendësojnë fjalët 'UNMIK'.

11.1.4 Neni 6.1 i Rregullores 2000/8 do të vazhdojë të jetë në fuqi. Termi 'udhëzimi administrativ dhe ligji në fuqi' duhet të përfshijë Urdhëresën Administrative 2002/22 dhe këtë Udhëzim.

11.2 Emri i biznesit

11.2.1 Emri i biznesit individual duhet të jetë emri i pronarit derisa emri i Ortakërisë së përgjithshme do ti përmbajë mbiemrat e ortakëve.

11.2.2 Çdo individ ose ortakëri i cili dëshiron ta shfrytëzojë Emrin tregtar (shihë nenin 9.3 më lartë) duhet të alikojnë për regjistrim të Emrit tregtar.

11.3 Detyrimet

11.3.1 Inspektorët e Zyres së regjistrimit të biznesit mund ti njoftojnë të gjitha bizneset e paregjistruara se duhen të aplikojnë për regjistrim brenda periudhës prej 7 ditësh. Fletëparaqitjet e arritura pas asaj date do të duhet ta paguajnë dënimin prej 20 € për

secilin muaj vonese, të llogaritur nga data kur është dërguar njoftimi, dënim ky i cili duhet të paguhet në të njëjtën kohë kur edhe taksa e regjistrimit.

- 11.3.2 Neni 6.4 i Rregullores 2000/8 do të vazhdojë të aplikohet. Nëse biznesi punon pa u regjistruar mund të bëhet mbyllja e tij nga ana e policisë.

12 Dorëzimi dhe mbledhja e dokumentave

- 12.1 Fletëparaqitjet për regjistrim ose dokumentet tjera të nevojshme për regjistrim do të dorëzohen në zyrat regjionale të MTI-së.
- 12.2 Zyrat regjionale, kopjet e dokumenteve të arritura do t'i vulosin me datën e arritjes dhe kjo do të jetë dëshmi se dokumentet janë pranuar. Ata poashtu, do t'i këshillojnë aplikuesit kur do të bëhen gati dokumentet e tyre. Ata poashtu, mund të lëshojnë konfirmim zyrtar se dokumentet janë pranuar.
- 12.3 Kur fletëparaqitjet ose dokumentet tjera nuk pranohen për regjistrim nga ana e Zyres së regjistrimit, ato do ti kthehen aplikuesit përmes zyrës regjionale të MTI dhe do përcillen me një letër ku do të spjegohet arsyeja e refuzimit.
- 12.4 Ai i cili i merr dokumentet nga zyra regjionale e MTI-së duhet të nënshkruajnë kopjen e letrës së refuzimit si dëshmi se i kanë marrë dokumentet. Kjo procedurë është paraparë si rezultat i kërkesave të cilat dalin nga neni 10.4 i UA 2002/22.

13 Taksat

- 13.1 Urdhëresa Administrative ka paraparë taksa të reja. Këto mund të paraqiten si vijonë:

Për shoqëritë aksionare, Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe Ortakëritë e kufizuara.

Fletë paraqitja për regjistrim	10 €
Arkivimi i statutit ose memorandumit të rinj	10 €
Ndryshimet në statut ose memorandum	10 €
Njoftimi mbi shuarjen e biznesit	10 €
Terheqja e njoftimit për shuarje të biznesit	10 €
Regjistrimi i mëvonshëm i Njësisë punuse.....	10 €
Regjistrimi i Rezervimi i emrit të biznesit	5 €
Regjistrimi ose ripërtrirja e Emrit tregtar	5 €
Transferi i emrit tregtar	5 €
Ndryshimet në Bordin e drejtorëve	5 €
Ndryshimet në zyrën e regjistruar dhe/ose agjentin	5 €
Raportet vjetore	5 €
Pasqyra financiare	5 €
Dorëzime tjera	5 €
Pranimi i Çertifikatës së re	2 €
Vertetimet lidhur me pronarin dhe Drejtorët	2 €
Vulosja e fotokopjes së ertigikatës	2 €
Dorëzimi i totalit.....	0.30 €/për faqe të shtypur

- 13.2 Për shoqëritë aksionare, Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe Ortakëritë e kufizuara të cilat nuk e kanë të dorëzuar statutin ose memorandumimin me rastin e regjistrimit të

përkohshem si dhe për regjistrime të reja, përveç shumës prej 10 € për fletëparaqitje paguajn edhe 10 € shtesë për arkivimin e statutit ose memorandumit.

Bizneset individuale dhe Ortakëritë e përgjithshme

Regjistrimi i biznesit individual dhe Ortakërisë së përgjithshme.....	5 €
Regjistrimi ose ripërtirja e Emrit tregtar.....	5 €
Kerkesa për shuarje të biznesit	5 €
Ndryshimet në detajet e regjistruara	5 €
Terheqja e njoftimit për shuarje të biznesit	10 €
Regjistrimi i mëvonshëm i njësisë punuese.....	5 €
Dorëzime tjera	3 €
Pranimi i Çertifikatës së re	2 €
Vertetimet lidhur me pronarin dhe Drejtorët	2 €
Vulosja e fotokopjes së Çertifikatës.....	2 €
Dorëzimi i totalit.....	0.30 €/për faqe të shtypur

13.3 Taksat duhet të paguhet më parë në banka në llogari të Zyres së regjistrimit. Fatura e pagesës duhet ti shoqërojë dokumentet të cilat dorëzohen në zyrat regjionale për regjistrim.

13.4 Taksa e paguar duhet të përfshijë edhe taksës e paguar në rast të vonimit për regjistrim. Dënimet janë llogaritur kështu :

- a) Për të gjitha vonesat nga pika 13.1 përveç shumës së taksës pafuhet edhe kompenzimi shtesë prej 20

13.5 Për kërkesat e organeve dhe Agjencioneve qeveritare dokumentet dhe shenimet tjera ipen pa inkasimin e çfardo takse.

14 Qasja publike në informata

14.1 Informatat e dorëzuara në Zyre të regjistrimit sipas rregulloras 2001/6 dhe UA 2002/22 janë informata publike.

14.2 Në informatat nga baza e shënimeve e Zyres së regjistrimit të biznesit mund të ket qasje pa pagesë në faqjen e internetit e cila do të jetë funksionale prej **[01 prillit 2003]**.

14.3 dokumenteve të cilat mbahen nga ana e Zyres së Regjistrimit. Taksa shtesë prej **[2 €]** paguhet për një vërtetim të tillë nga ana e Regjistruesit.

15 Dorëzimi i Çertifikatave

Neni 3.4 i Rregullores 2000/8 mbi Regjistrimin e përkohshëm të bizneseve në Kosovë, për dorëzimin e çertifikatave të regjistrimit të përkohshëm duhet të aplikohet njëjtë edhe për çertifikatat mbi inkorporim të lëshuara sipas Rregullores 2001/6 dhe UA 2002/22. Çertifikatat origjinale të inkorporimit duhet të mbahen me librat dhe llogaritë e biznesit dhe duhet të jenë në dispozicion për inspektim nga ana e autoriteteve përkatëse gjatë orarit të rregullt të punës. Kopja e çertifikatës duhet të jetë në një vend të dukshëm në të gjitha hapësirat ku Shoqëritë aksionare, Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara ose Ortakëritë e kufizuara udhëheqin veprimtarinë e tyre.

16 Korrespondenca e bizneseve

- 16.1** Neni 3.5 i Rregullorës 2000/8 i cili ka të bëjë me përfshirjen e informatave specifike mbi korrespondencën si dhe dokumentet tjera të biznesit të lëshuara nga Shoqëria aksionare, Shoqëria me përgjegjësi të kufizuara ose Ortakëria e kufizuar do të vazhdojnë të aplikohen ashtu që të gjitha letrat, faturat, porositë, pranimi i porosive, kontratat dhe dokumentet tjera të ngjashme të lëshuara nga Shoqëria aksionare, Shoqëria me përgjegjësi të kufizuara ose Ortakëria e kufizuar duhet të përmbajnë Emrin e regjistruar, adresën e regjistruar të zyres, fjalët ‘e inkorporuar në Kosovë’ si dhe numrin e regjistrimit.
- 16.2** Të gjitha korespondencat dhe dokumentet tjera të biznesit siç janë faturat, porositë, pranimi i porosive, kontratat, etj. të lëshuara nga bizneset individuale ose Ortakëritë e përgjithshme duhet të përmbajnë emrin e pronarit ose pronarëve të biznesit.
- 16.3 Teksti i spastruar zëvendëson tekstin e Udhëzimit Administrativ nr. 2003/1 të datës 11.02.2003

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Dr. Ali Jakupi, Ministër